



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.5.2023

Nr: 494

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 404, NGA Z.IVI KASO, PËR HAPJEN E ZYRAVE ZGJEDHORE AFËR QENDRAVE TË VOTIMIT, NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", NË BASHKITË LUSHNJË DHE TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 11.5.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: Z. Ivi Kaso

OBJEKTI: Kërkohet marrja e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për hapjen e zyrave zgjedhore afër qendrave të votimit nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste", në bashkitë Tiranë dhe Lushnjë.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar si dhe neni 5, pika 1, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me nr. 404 ID, datë 9.5.2023, me denoncues z. Ivi Kaso.

Z. Kaso pretendon se: "subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" ka hapur zyra zgjedhore afër qendrave të votimit, në bashkitë Lushnjë dhe Tiranë, si më poshtë vijon:

Data: 11.5.2023 Nr: 494
Ora: 12:00



Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 404, nga z.Ivi Kaso, për hapjen e zyrave zgjedhore afër qendrave të votimit, nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", në bashkitë Lushnjë dhe Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

- zyrë zgjedhore e Partisë Socialiste 40 metra nga vendndodhja e qendrës së votimit, “Shkolla e Mesme Dhimitër Mino”, në Bubullimë të Lushnjës;
- zyrë zgjedhore e Partisë Socialiste 99 metra nga dy qendrat e votimit nr. 2919 dhe nr. 2924, përkatësisht Shkolla 9 vjeçare dhe ajo e mesme e Krutjes;
- zyrë zgjedhore e Partisë Socialiste si dhe qendra e votimit nr. 2826 ndodhen në një distancë shumë të afërt në Golem të Lushnjës,
- zyrë zgjedhore e Partisë Socialiste ndodhet vetëm 50 metra distancë nga qendra e votimit, shkolla “Avni Rustemi”, në Tiranë”.

Pala kërkuese kërkon marrjen e masave të menjëhershme përfshirë sanksionet që parashikojnë dispozitat ligjore për këtë qëllim, lidhur me veprimet e kryera, sipas provave të paraqitura.

Lidhur me njësinë administrative Golem, Lushnjë është raportuar edhe nga monitoruesi i caktuar në Bashkinë Lushnjë më datë 9.5.2023 (pjesë e raportimit tek shqyrtimi i raporteve të monitoruesve për periudhën 9-10 maj 2023).

Në vijim të procedurës administrative, KQZ filloi hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me pretendimet e denoncuesit. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka kërkuar nga monitoruesit e caktuar nga KQZ-ja për monitorimin e Bashkisë Lushnjë dhe Tiranë, nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion në lidhje me çfarë pretendohet nga denoncuesi.

Referuar informacionit të dërguar nga monitoruesit rezultoi se:

- zyra zgjedhore në Bubullimë ndodhet afërsisht 50 metra nga qendra e votimit, shkolla e mesme “Dhimitër Mino”;
- zyra zgjedhore në Krutje ndodhet afërsisht 100 metra nga qendrat e votimit nr. 2919 dhe nr. 2924;
- zyra zgjedhore në Golem është hequr dhe funksionon vetëm si qendër votimi (raportuar me datë 11.5.2023);
- zyra zgjedhore në Tiranë ndodhet më afër se 50 metra nga qendra e votimit shkolla “Avni Rustemi”.

Raportet e monitoruesve janë shoqëruar me foto.

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi, si dhe raportet e monitoruesve vlerësojmë se, zyrat zgjedhore në Bubullimë dhe Krutje, Bashkia Lushnjë si dhe zyra zgjedhore në Bashkinë Tiranë, janë vendosur në kundërshtim të nenit 5, pika 1, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f ” dhe “n”, e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenin 5, pika 1, të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

Data: 11.5.2023 Nr: 494
Ora: 12:00



Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 404, nga z.lvi Kaso, për hapjen e zyrave zgjedhore afër qendrave të votimit, nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në bashkitë Lushnjë dhe Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

V E N D O S:

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Tiranë dhe Lushnjë, për mbylljen e menjëhershme të zyrave zgjedhore të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, si më poshtë vijon:
 - Zyra zgjedhore afër qendrës së votimit “Shkolla e Mesme Dhimitër Mino” në Bubullimë, Bashkia Lushnjë;
 - Zyra zgjedhore afër qendrave të votimit nr. 2919 dhe nr. 2924 në Krutje, Bashkia Lushnjë;
 - Zyra zgjedhore afër qendrës së votimit, Shkolla “Avni Rutemi”, Bashkia Tiranë.
2. Ngarkohen subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Tiranë dhe Lushnjë, për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
3. Ky vendim t’u njoftohet menjëherë subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Tiranë dhe Lushnjë nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI